



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Shtojca 12

Datë 05.11.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)

Drejtuar: Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë “LIS KONSTRUKSION” shpk & “S I R E T A 2F shpk
Adresë: Diber Bulqize Lagjja Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15.
Adresë: Tiranë Paskuqan, Lagjja Babrru

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e Hapur - Punë”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF- 21199-09-23-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “**Ndërtimi i Qendrës Multifunkionale Kampusi Rinor pranë Drofpp nr.4 Tiranë**”

Kohëzgjatja e kontratës: **18 (tetëmbëdhjetë) muaj.**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike 65 datë 30 Shtator 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE BE-IS shpk me NUIS K71412003A & XHASt shpk me NUIS K12512837I

Vlera: **187,403,327** (njëqind e shtatëdhjetët milion e katërqind e tre mijë e treqind e njëzetë e shtatë) lekë pa TVSH

2. OE DAJTI PARK 2007 shpk me NUIS K11507003S

Vlera: **158,617,827.28** (njëqind e pesëdhjetët e tetë milion e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzetë e shtatë pik njëzetë e tetë) lekë pa TVSH

3. OE DION AL shpk me NUIS K67917301H

Vlera: **147,057,784.57** (njëqind e dyzetë e shtatë milion e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër pik pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH

4. BOE ED KONSTRUKSION shpk me NUIS K61625001I & VIANTE Konstruksion shpk me NUIS K47103804L

Vlera: **179,597,190.15** (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e nëntëdhjetë pik pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH

5. BOE GSM KLIMAIRE shpk me NUIS L26804206O dhe ARIFAJ shpk me NUIS J76418907K

Vlera: **187,597,761** (njëqind e tetëdhjetë e shtatë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH

6. IGROUP shpk me NUIS M01406012K

Vlera: **0** (zero) lekë pa TVSH

7. OE INA shpk me NUIS J61814009W

Vlera: **163,134,376** (njëqind e gjashtëdhjetë e tre milion e njëqind e tridhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

8. OE INERTI shpk me NUIS J66926804L

Vlera: **153,717,011.66** (njëqind e pesëdhjetë e tre milion e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëmbëdhjetë pik gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

9. OE K A C D E D J A shpk me NUIS K51712017A

Vlera: **175,489,689.92** (njëqind e shtatëdhjetë e pesë milion e katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë pik nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH

10. OE KEVIN KONSTRUKSION shpk me NUIS K71401004W

Vlera: **182,145,366.52** (njëqind e tetëdhjetë e dy milion e njëqind e dyzetë e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pik pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH

11. BOE L.T.E CONSTRUCTION shpk me NUIS L78006801F & B93 II shpk me NUIS L52209050O & J O G I shpk me NUIS J63229478K

Vlera: **161,779,397.65** (njëqind e gjashtëdhjetë e një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë pik gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH

12. BOE LIS KONSTRUKSION shpk me NUIS K66613407H & “S I R E T A 2F” shpk me NUIS K51501008J

Vlera: **152,170,257.75** (njëqind e pesëdhjetë e dy milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë pik shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH

13. OE LLAZO shpk me NUIS K24218401K

Vlera: **185,074,839** (njëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH

14. BOE NDERTIMI shpk me NUIS K11325002C & NDREGJONI shpk me NUIS K31329048I

Vlera: **162,136,815** (njëqind e gjashtëdhjetë e dy milion e njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH

15. BOE NIKA shpk me NUIS J76705047U & MANE/S shpk me NUIS J64103865K

Vlera: **153,381,842.12** (njëqind e pesëdhjetë e tre milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e dyzetë e dy pik dymbëdhjetë) lekë pa TVSH

16. BOE REJ shpk me NUIS J93711608Q & DESARET COMPANY shpk me NUIS K01816001J

Vlera: **187,735,768.33** (njëqind e tetëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë pik tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE INERTI shpk me NUIS J66926804L

Për arsye se:

OE nuk ploteson piken **2.3.10/a** *Për pajisjet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.10, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto paisje. Në rast paraqitje autorizim distributori autorizuar, duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore të kerkuara .*

Për paisjen nr. 407 Ashensor 630 kg, OE ka përcaktuar në tabelën përkatëse si kompani prodhuesese AH&MET Turqi dhe distributor Kleo Ashensor shpk, ndërkohë ka ngarkuar

bashkëlidhur: autorizim nga shoqëria Kleo Ashensor të shoqëruar me foto ashensorësh pa parametra teknike dhe licensë nr ZN 8169 të Kleo Ashensor me kategorinë NS3-A (impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues) vlefshmëria e të cilës ka përfunduar në datë 26.06.2024. OE nuk ka paraqitur asnjë dokument që vërteton se Kleo Ashensor shpk është distributor i kompanisë AH&MET Turqi dhe as katalog të ashensorëve të kësaj kompanie duke mos e plotësuar kriterin për kualifikim.

2. OE DAJTI PARK 2007 shpk me NUIS K11507003S

Për arsye se:

OE nuk plotëson piken **2.3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me licensë leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.**

OE ka paraqitur licensë të lëshuar nga QKB me kodin III.2.B me veprimtari: “ Grumbullim, ruajtje dhe transport i mbetjeve urbane” me të ndrejtën për të administruar mbletje jo të rrezikshme sipas shtojcës 1 në të cilën përfshihen nënkategori të kodit 20 (mbetje urbane).

Kjo licensë nuk përputhet me licensën e kërkuar AK ku veprimtaria duhet të jetë *Grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta* e cila përfshin kodin 17 (Mbetje nga ndërtimet).

OE nuk plotëson kërkesën e mësipërme për kualifikim.

3. BOE L.T.E CONSTRUCTION shpk me NUIS L78006801F & B93 II shpk me NUIS L522090500 & J O G I shpk me NUIS J63229478K

Për arsye se:

-BOE ka paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit se bashku me preventivin për ndarjen e punëve dhe furnizimeve në të cilën konstatohet se për të gjithë zerrat e preventivit secili OE do të realizoj sasinë përkatëse në përputhje me % e mara përsipër.

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistem konstatohet se:

Për plotësimin e kriterit për kualifikim **2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:**

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **NP-1A** Punime gjermimi në tokë
- **NP-2E** Ndertime civile dhe industriale
- **NP-7 A.** Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.
- **NP-12A** Punime të inxhinierisë së mjedisit

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **NS-1A** Punime për prishjen e ndërtimeve.
- **NS-2A** Impiante hidro-termosantare dhe mirëmbajtja e tyre.
- **NS-3A** Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)
- **N.S-4 B** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- **NS-9A** Punime Strukturore Speciale
- **NS-12 B** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- **NS- 14 B** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- **N.S – 18 A** Punime topogjeodezike

OE L.T.E CONSTRUCTION shpk ka kategorine NP-12A nga NP-12B e kërkuar edhe pse ka marë 84% të punimeve.

OE J O G I shpk nuk ka kategorinë NR-9 dhe NP-12 edhe pse ka 9% te punimeve te gjithë zerave të preventivit.

BOE nuk përmbush kërkesën për kualifikim

Për plotësimin e pikës **2.3.12** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001-2015** (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015** (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën **ISO 45001:2018** (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë) ose ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d) Çertifikatën e menaxhimit te energjise **ISO 50001-2018**/ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Konstatohet se:

OE B93 II shpk ka paraqitur ISO 50001-2018 të cilës i ka mbaruar vlefshmërinë në datë 05.10.2024

OE J O G I shpk nuk ka paraqitur ISO 50001-2018 edhe pse te dy OE kanë marrë përsipër të realizojnë % për secilin zë të preventivit.

BOE nuk e plotëson këtë kriter

- Për plotësimin e pikës **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

OE L.T.E CONSTRUCTION shpk dhe subjekti mbështetës INFINIT SHPK nuk kanë plotësuar sic duhet formularin e vetëdeklarimit seksioni A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

- Për plotësimin e **2.3.6** Një punësim minimalisht prej **65** (gjashtëdhjetë e pesë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.....

Rezulton se OE L.T.E CONSTRUCTION shpk ka 36 punonjës ku në bazë të % prej 84 të marrë përsipër duhet të kishte 54.6 punonjës. OE nuk plotëson kriterin për kualifikim

- Për plotësimin e **2.3.5** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

1 (një) Arkitekt

1 (një) Inxhinier Ndertimi

1 (një) Inxhinier Hidroteknik

1 (një) Inxhinier Elektrik

1 (një) Inxhinier Mekanik

1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder

1 (një) Inxhinier Elektronik/IT/Telekomunikacion

1 (një) Inxhinier Mjedisi

OE B93 II shpk ka paraqitur vetëm 1 ing ndërtimi dhe 1 ing mekanik duke mos patur stafin e nevojshëm për realizimin e punimeve të mara përsipër.

OE nuk ka paraqitur asnjë punonjës të certifikuar për sigurinë në punë dhe ekspert për ndrihmën e parë duke mos plotësuar as kriterin 2.3.8

OE nuk ka paraqitur asnje makineri duke mosplotësuar edhe kriterin 2.3.7

4. BOE NDERTIMI shpk me NUIS K11325002C & NDREGJONI shpk me NUIS K31329048I

Për arsye se:

OE nuk ploteson piken **2.3.7**. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve..... ka paraqitur tabën e kërkuar me stafin e teknik në të cilën konstatohet se 2 punonjës skelerie të paraqitur nga anëtar Ndregjoni shpk janë të certifikuar nga CERTIS Shpk me NIPT M01930006J e cila nuk është e akredituar për trajnime të punonjësve të skelerisë. OE nuk plotëson kërkesën e mësipërme për kualifikim.

Nga verifikimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet OE dhe ndarjes së punimeve konstatohet se OE NDREGJONI shpk do të furnizoje paisjet përkatësisht me nr. Rendor 370, 374, 391,392,393,394 ndërsa OE NDËRTIMI shpk vetëm pasijen me nr. Rendor 407. Nga vlerësimi i dokumentacionit të sjell nga operatorët konstatohet se operatori Ndregjoni shpk nuk ka paraqitur deklaratë, ku merr përsipër të garantojë instalimin si dhe servisin e pajisjeve gjatë periudhës së garancisë (2 vite), për defektet që vijnë nga prodhimi i tyre sipas përcaktimit në pikën 2.3.11 të kërkesave për kualifikim ndërsa OE NDËRTIMI shpk e ka sjell këtë deklaratë në emrin e vet dhe jo të BOE. Gjithashtu të gjitha autorizimet nga distributorët dhe prodhuesit sipas pikës **2.3.10/a** të kërkesave për kualifikim janë marë në emër të OE NDERTIMI shpk edhe pse ky OE do të furnizojë vetëm paisjen ashensor. Për sa më lartë OE NDREGJONI nuk plotëson zërat e marë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit.

BOE skualifikohet për mosplotësim të kërkesave për kualifikim

5. OE K A C D E D J A shpk me NUIS K51712017A

Për arsye se:

OE nuk ploteson piken **2.3.5** *“Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:*

1 (një) Arkitekt

1 (një) Inxhinier Ndertimi

1 (një) Inxhinier Hidroteknik

1 (një) Inxhinier Elektrik

1 (një) Inxhinier Mekanik

1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder

1 (një) Inxhinier Elektronik/IT/Telekomunikacion

1 (një) Inxhinier Mjedisi

OE, Ka paraqitur Licensë profesionale nr. 4951/26 dhe formularin e vetdeklarimit në të cilën konstatohet se ky Operator nuk ka Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder.

OE nuk plotëson kërkesën për kualifikim, pika **2.3.7**. *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional....*

OE ka paraqitur tabelen përkatëse me specilaistë në të cilën konstatohet se të gjithë punonjësit me përjashtim të 1 hidraulik dhe manovratorëve janë të certifikuar nga Qendra e Formimit Profesional ASHP me NIPT L21410066G e cila nuk është e licensuar për trajnime personeli në fushat e kërkuara nga AK (punonjës gipsi, fasade, hekurthyes, karpentier, elektrikist, instalues kondicioneri, skeleri, hidrizolues, suvatues pallkashtrues, bojaxhi). Kjo bazuar dhe në vendimin e KPP nr.745/2022.

6. BOE GSM KLIMAIRE shpk me NUIS L26804206O dhe ARIFAJ shpk me NUIS J76418907K

Për arsye se:

BOE, ka ngakuar në sistem marrëveshje bashkëpunimi në të cilën ka paraqitur ndarjen në % dhe OE përfaqësues të bashkimit por nuk ka ngarkuar preventivin e punime ku të përcaktohet qartë puna dhe paisjet që do të furnizojë secili OE. Marrëveshja konsiderohet jo në përputhje me përcaktimet e nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021 e ndryshuar

BOE, nuk plotëson **pikën 2.3.10/a** e cila përcakton:

”Për pajisjet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.10, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto paisje. Në rast paraqitje autorizim distributori autorizuar, duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore të kërkuara”.

BOE ka paraqitur për paisjen me nr. Rendor 391 Furnizim Njësi e jashtme Inverter..... ka paraqitur autorizim nga kompania Best-Tech AL 2000 shpk si distributor për paisjet dhe katalog të kondicionerëve të markës HAIER dhe nuk ka ngarkuar asnjë dokument vërtetues të lidhjes së këtij distributori me kompaninë HAIER.

Gjithashtu për paisjen NR 407 Ashensor me peshë 630kg, BOE ka paraqitur autorizim nga Person Fizik “Miranad Zhaka” si distributor i kompanisë HASPAR dhe katalog të ashensorëve HASPAR

por nuk ka ngarkuar dokumentin nga prodhuesi që përcakton se personi fizik Miranad Zhaka është distributor i produkteve HASPAR.

7. OE KEVIN KONSTRUKSION shpk me NUIS K71401004W

Për arsye se:

OE nuk ploteson pikën 2.3.7. e cila përcakton: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional....’

OE ka paraqitur tabelen përkatëse me specilaistë në të cilën konstatohet se 18 punonjë (staf teknik) janë të certifikuar nga Qendra e Formimit Profesional ASHP me NIPT L21410066G e cila nuk është e licensuar për trajnime personeli në fushat e kërkuara nga AK (punonjës gipsi, fasade, hekurthyes, karpentier, elektrikist, instalues kondicioneri, skeleri ..etj) . Kjo bazuar dhe në vendimin e KPP nr.745/2022.

8. BOE REJ shpk me NUIS J93711608Q & DESARET COMPANY shpk me NUIS K01816001J

Për arsye se:

BOE nuk ka paraqitur deklaratë ku merr përsipër të garantojë instalimin si dhe servisin e pajisjeve gjatë periudhës së garancisë (2 vite), per defektet qe vijnë nga prodhimi i tyre. Sic kërkohet në pikën **2.3.11 të KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, PIKA 20.3 KAPACITETI TEKNIK**

OE DESARET Company shpk nuk ka ngarkuar në sistem dokumentin Vërtetim xhiro e 3 viteve të fundit financiare sic kërkohet në pikën **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 2**

9. IGROUP shpk me NUIS M01406012K

Për arsye se:

OE nuk ka ngarkuar asnjë dokumentacion për këtë procedurë prokurimi.

10. OE DION AL shpk me NUIS K67917301H

Për arsye se:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar**, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82,të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “**Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në**

shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”. OE nuk paraqiti dokumentacionin sipas nenit të sipercituar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë “**LIS KONSTRUKSION**” shpk & “**S I R E T A 2F** shpk, me Adresë: Diber Bulqize Lagjja Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15. dhe adresë Tirane Paskuqan, Lagjia Babrru Fushe, me nr. NUIS K66613407H & K51501008J, se oferta e paraqitur, me vlerë totale prej **152,170,257.75** (njëqind e pesëdhjetë e dy milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë pik shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” .